




Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government

Ministria e Drejtësisë / Ministarstvo Pravde / Ministry of Justice

Nr. ref.: 33/2012

Në pajtim me nenin 8 dhe nenin 9, paragrafët 1, 4, 5 dhe 6 të Ligjit Nr. 03/L-010 për Noterinë; nenin 8 të Udhëzimit Administrativ Nr. 09/2011 për Procedurën e Konkurimit dhe Përzgjedhjen e Zyrave Noteriale; duke u mbështetur në listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet e pranueshmërisë në Shërbimin Noterial të Komisionit për Përzgjedhjen e Noterëve, si dhe duke vepruar në pajtim me nenin 8, nënparagrafin 1.4, të Rregullores Nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive,

Ministri i Ministrisë së Drejtësisë merr këtë:

VENDIM PËR EMËRIMIN E NOTERIT

1. Z. Halil (Osman) Rrukiqi emërohet në detyrën e Noterit.
2. Jurisdiksioni territorial i zyrës noteriale të z. Halil Rrukiqi përfshinë territorin e Komunës së Gllogovcit.
3. Në pajtim me nenin 19, paragrafin 1, të Ligjit për Noterinë, obligohet i emëruari që brenda periudhës një (1) mujore nga dita e hyrjes në fuqi të këtij vendimi, t'ia ofrojë Ministrisë së Drejtësisë dokumentin, i cili tregon dorëheqjen nga funksioni i tij aktual zyrtar.
4. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.


Prishtinë,
16 mars 2012

Vendimi i dërgohet:

- Të emëruarit;
- Arkivit;
- Odës së Noterëve.



Zëvendëskryeministri dhe Ministri i Drejtësisë:


Prof. Dr. Hajredin Kuçi